



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr. 45 Prot.

Tiranë, më 07/01/2025

URDHËR

NR. 4 DATË 07/01/2025

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 5, DATË 18.01.2022 “PËR
MIRATIMIN E METODOLOGJISË MBI PROCEDURAT E FINANCIMIT TË
ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE TË AUTORIZUARA NGA MINISTRI I
DREJTËSISË”**

Në mbështetje të nenit 15 të Ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga Shteti”;
Vendimit nr.110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së
organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga
shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, të ndryshuar me
Vendimin nr. 227 datë 13.04.2023: Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e
Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas” miratuar me Urdhër nr. 393 datë 23.11.2020, të Ministrit të
Drejtësisë;


URDHËROJ:

1. Miratimin e metodologjisë mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga ministri i drejtësisë, sipas ndryshimeve përkatëse.
2. Ngarkohet komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim të organizatave jofitimprurëse të autorizuara, komisioni i ankimit për shqyrtimin e ankesave dhe anëtarët e Sekretariatit Teknik, për zbatimin e kësaj metodologjie.
3. Ngarkohet Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për publikimin e metodologjisë me qëllim njohjen nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara.
4. Ngarkohet Sektori i Protokollit të kryejë veprimet e nevojshme për njoftimin e këtij Urdhri.

Ky urdhër hyj në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Ergj



Rruga

Mirë Mija Tiranë

MINISTRIA E DREJTËSISË

Metodologjia mbi procedurat e financimit të organizatave jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë



DREJTORIA E NDHIMËS JURIDIKE FALAS

Rr. "Jordan Misja", Njësia Administrative nr. 9, godina nr. 3, Tiranë
 ëëë.ndihmajuridike.gov.al

Tabela e përmbajtjes:

| | |
|--|----|
| Hyrje..... | 2 |
| Objektivat e përfitimit financiar:..... | 4 |
| Etapat në të cilën planifikohen fondet për financimin e Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara | 5 |
| Plani Vjetor i Financimit i Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara..... | 5 |
| Shuma e përfitimit financiar për vitin fiskal: | 6 |
| Objektivat e përfitimit financiar sipas objektivave të identifikuara: | 6 |
| Numri i përfaqësuesve të organizatave që mund të përfshihen në procesin e përzgjedhjes:..... | 6 |
| Koha e hapjes së thirrjes për aplikime:..... | 7 |
| Koha e fillimit të zbatimit të ofrimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti: | 7 |
| Plani i punës mbi financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuara | 8 |
| Hapja e thirrjes së përgjithshme për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuara | 11 |
| Aneks 1: Lista e dokumentave të nevojshëm për aplikim..... | 11 |
| Aneks 2: Formular TIP i Aplikimit:..... | 13 |
| Aneks 3: Plani i financiar i aktiviteteve dhe pagesave..... | 16 |
| Aneks 4: Formati raportit të realizimit të projektit sipas fazave | 11 |
| Ngritja e Komisionit të Vlerësimit dhe Komisionit të Ankimit | 18 |
| Ngritja e Sekretariatit Teknik..... | 18 |
| Deklarata e paanshmërisë dhe konfidencialitetit..... | 19 |
| Aneks 5: Formular i deklaratës së paanshmërisë, konfidencialitetit dhe shmangies së konfliktit të interesit...20 | |
| Aneks 6: Deklaratë mbi financimin e dyfishtë..... | 21 |
| Vlerësimi paraprak i projekt-propozimeve..... | 20 |

| | |
|---|----|
| Renditja dhe përzgjedhja e projekt-propozimeve..... | 21 |
| Tabelë vlerësimi përmbledhëse e Projekt-Propozimit..... | 23 |
| Informacion sqarues mbi tabelën e vlerësimit..... | 25 |

Hyrje

Kjo metodologji shërben si një udhëzues i cili do ti mundësojë organizatave jofitimprurëse të autorizuar si dhe Komisionit të Vlerësimit/Komisionit të Ankimit që të zbatojnë në mënyrë të unifikuar kriteret; procedurat dhe mënyrën e vlerësimit të projekt-propozimeve të përcjella për financime nga buxheti i Shtetit.

Në përpilimin e këtij akti janë marrë për bazë: “Metodologjia për alokimin e fondeve për organizatat e shoqërisë civile” përgatitur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian; Rregullorja e Ministrisë së Financave të Kosovës, nr–04/2017, “Mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të Ojq-ve” si dhe aktet e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile të cilat marrin për bazë praktikatat e mira rajonale dhe ndërkombëtare që mundësojnë zbatimin me transparencë të thirrjeve publike për financimin e projekteve dhe programeve të OJF-ve përmes fondeve publike.

Bazuar në nenin 15, pika 3 të Ligjit Nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, organizatat jofitimprurëse të autorizuar për dhënien e ndihmës juridike parësore përfitojnë financime nga buxheti i shtetit, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje. Procedura, rregullat e përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse të autorizuar, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre përcaktohen në VKM Nr.110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, të ndryshuar me VKM nr. 227, datë 13.04.2023.

Të gjitha organizatat jofitimprurëse të autorizuar për t’u kualifikuar për të përfituar financime, duhet të plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në pikën 6 të VKM-së Nr.110, datë 6.3.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, të ndryshuar si më poshtë vijon:

a) **Kritere të përgjithshme:**

i) të kenë marrë autorizimin nga Ministri i Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti;

ii) të mos kenë dy burime të njëjta financimi për të njëjtin aktivitet;

- Nëse një organizatë ka një projekt që ka të përfshirë si aktivitet “ofrimin e ndihmës juridike parësore, fizikisht,” sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, kjo e fundit nuk mund të aplikojë për financim pranë DNJF pasi në këtë rast jemi përpara 2 burimeve të financimit për të njëjtin aktivitet;
- Nga ana tjetër nëse një organizatë ka një projekt që ka të përfshirë si aktivitet ofrimin e ndihmës juridike falas online apo ndërgjegjësimin e qytetarëve nëpërmjet zhvillimit të aktiviteteve informuese, atëherë kjo organizatë mund të aplikojë për financim pranë DNJF për dhënien e ndihmës juridike parësore fizikisht pasi nuk janë 2 aktivitete të njëjta për të cilat do të jepet financim.
- Nga ana tjetër nëse një organizatë ka një projekt që ka të përfshirë si aktivitet ofrimin e ndihmës juridike dytësore, atëherë kjo organizatë mund të aplikojë për financim pranë DNJF për dhënien e ndihmës juridike parësore fizikisht pasi nuk janë 2 aktivitete të njëjta për të cilat do të jepet financim.

b) Kritere të veçanta:

i) projektpropozimin, i cili përmban të dhënat teknike-financiare për ofrimin e shërbimit, qëllimin, objektivat specifike, aktivitetet, kalendarin e realizimit, rezultatet e synuara, përfituesit e drejtpërdrejtë;

ii) të dhëna për personelin, duke specifikuar detyrat dhe siguruar jetëshkrimin e tyre;

iii) të dëshmojnë se kanë përvojë në realizimin e shërbimeve të ngjashme, duke siguruar dokumente dhe të dhëna të realizimit të shërbimeve të ngjashme në të kaluarën (*kontrata granti me objekt të ngjashëm*);

Organizata jofitimprurëse e autorizuar duhet të dëshmojë se i plotëson kriteret e përgjithshme dhe të veçanta duke dorëzuar dokumentet përkatëse sipas thirrjes publike. Në rast të mosplotësimit të një prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta veçanta, shoqëruar me dokumentat përkatëse të thirrjes, aplikimi konsiderohet i paplotë dhe, si i tillë, nuk kualifikohet për përfitimin financiar.

Në kërkesën për përfitimin e financimit duhet të përcaktohet lista e çdo dokumenti që do i bashkëlidhet kërkesës për financim, duke specifikuar edhe numrin e faqeve që përban çdo dokument.

❖ **Objektivat e përfitimit financiar:**

Objektivi i përgjithshëm: Sigurimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” në mënyrë profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive.

Organizata jofitimprurëse e autorizuar, përgjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj do të ushtrojë një shumëllojshmëri shërbimesh ligjore në fushën e ndihmës juridike parësore si vijon:

- i) dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;
- ii) dhënia e këshillimit;
- iii) dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;
- iv) dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;
- v) përfaqësimi përpara organeve administrative; dhe
- vi) dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

Duke marrë në konsideratë numrin mesatar të rasteve të raportuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore, gjatë periudhës së zbatimit të këtij projekti duhet të synohet ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore **minimalisht për 200 (dyqind) raste në vit, por jo më pak se 50 (pesëdhjetë) raste çdo 3 (tre) muaj, referuar pikës 22 të VKM nr. 110/2019 të ndryshuar.**

- Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” **ndihmë juridike parësore nënkuptohet vetëm ndihma juridike e dhënë fizikisht për qytetarët (përmes nënshkrimit të formularëve tip të deklarimit) dhe jo ndihma juridike online;**
- Referuar kësaj thirrje, ndihma juridike do të ofrohet pranë zyrës/ambienteve në të cilën operon organizata jofitimprurëse e autorizuar;
- Referuar kësaj thirrje, **ndihma juridike do të ofrohet për të gjithë kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017**, pa u ndalur në trajtimin e rasteve të veçanta sipas objektivit të veprimtarisë së OJF-ve;
- Referuar kësaj thirrje, nuk financohet zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese apo edukimit ligjor të publikut por inkurajohet fakti që këto aktivitete të përfshihen në projekt-propozim si pjesë e detyrave funksionale të juristit të rekrutuar për ofrimin e ndihmës juridike parësore.

Në kuadër të hartimit të projekt-propozimit, aktivitetet kryesore që duhen ndërmarrë nga organizata jofitimprurëse e autorizuar në raste se shpallet fitues janë:

1. **Rekrutimi i 1 (një)** juristi për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti nga ana e organizatës;
2. Lidhja e kontratës së punës me organizatën jofitimprurëse të autorizuar që përfiton financim dhe **kryerja e pagesave mujore për pagat/sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (punëdhënës dhe punëmarrës)** për juristin që do të ofrojë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti;
3. **Ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore nga juristi i organizatës jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.**

❖ **Etapat në të cilën planifikohen fondet për financimin e Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara.**

1. Në zbatim të VKM “*Për miratimin e taveve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm*” për një periudhë 3 (tre) vjeçare, Ministria e Drejtësisë përcakton tavanet e shpenzimeve për çdo institucion varësie.
2. Në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas planifikon në mbështetje të objektivave fondet për financimin e OJF-ve sipas fazave të hartimit të pasqyrave të projekt-buxhetit afatmesëm.
3. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas deklaron në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar Shqiptar (AFMIS) fondet sipas programit buxhetor afatmesëm.

Referuar hapave të sipërcituara, bëhet i mundur planifikimi dhe çelja e fondeve në muajin Janar të vitit pasardhës, kohë në të cilën, në zbatim të VKM nr. 110 datë 06.03.2019, të ndryshuar, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas bën publike në faqen zyrtare të saj Planin Vjetor të Financimit të OJF-ve të autorizuar.

❖ **Plani Vjetor i Financimit i Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara**

Në pikën 4 të VKM-së 110/2019, parashikohet shprehimisht se: “*Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, brenda 1 muaji nga miratimi i buxhetit, bën publike në faqen zyrtare të saj planin vjetor të financimit që përmban:*

- a) *shumën e përfitimit financiar për vitin fiskal;*
- b) *objektivat e përfitimit financiar, sipas nevojave të identifikuar;*

c) numrin e përafërt të organizatave jofitimprurëse të autorizuara që mund të përfshihen në procesin e përzgjedhjes;

ç) kohën e hapjes së thirrjes për aplikime; dhe

d) kohën e fillimit të zbatimit të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti”.

❖ **Shuma e përfitimit financiar për vitin fiskal:**

Buxheti i miratuar ka përcaktuar për dhënien e ndihmës juridike parësore për individët që plotësojnë kushtet, në zbatim të ligjit për ndihmën juridike falas ***në total është në vlerën 8,000,000 lekë.***

❖ **Objektivat e përfitimit financiar sipas objektivave të identifikuara:**

Dhënia e ndihmës juridike parësore për kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” në mënyrë profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive;

Sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” ndihmë juridike parësore nënkuptohet vetëm ndihma juridike e dhënë fizikisht për qytetarët (përmes nënshkrimit të formularëve tip të deklaramit) dhe jo ndihma juridike online;

Ndihma juridike do të ofrohet pranë zyrës/ambienteve në të cilën operon organizata jofitimprurëse e autorizuar;

Ndihma juridike do të ofrohet për të gjithë kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, pa u ndalur në trajtimin e rasteve të veçanta sipas objektivit të veprimtarisë së OJF-ve;

❖ **Numri i përafërt i organizatave që mund të përfshihen në procesin e përzgjedhjes:**

Të gjitha organizatat jofitimprurëse të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë mund të përfshihen në procedurën e përzgjedhjes.

Në kushtet kur, referuar pikës 21 të VKM nr. 110/2019, çdo organizatë jofitimprurëse e autorizuar e përzgjedhur nuk mund të përfitojë më shumë se 20% të buxhetit të planifikuar për financimin e dhënies së ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti për organizatat jofitimprurëse, numri i përafërt i organizatave që mund të mbulohen me fondet e vitit 2025, është afërsisht 5 (pesë) organizata, referuar pikës 21 të VKM nr. 110/2019.

Do të shpallen fituese të financimit, Organizatat Jofitimprurëse me pikët më të larta vlerësuar nga Komisioni përkatës.

❖ **Koha e hapjes së thirrjes për aplikime:**

Referuar VKM 110/2019, të ndryshuar Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas njofton hapjen e thirrjes për aplikime, në faqen zyrtare të institucionit dhe pranë Buletinit të Njoftimeve Zyrtare, çdo fillim viti kalendarik.

Si pasojë, hapja e thirrjes sipas pikës 4 të VKM nr. 110/2019, të ndryshuar, do të realizohet brenda 1 (një) muaji nga miratimi i buxhetit vjetor.

❖ **Koha e fillimit të zbatimit të ofrimit të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti:**

Nëse i referohemi afateve procedurale të përcaktuara në VKM 110/2019, të ndryshuar, lidhja e kontratave të financimit parashikohet të realizohet brenda 3 (tre) muajve nga shpallja e thirrjes, sipas përcaktimeve të planit të punës mbi financimin, në vijim.

❖ **Plani i punës mbi financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuara**

| Vlerësimi/Analiza | Struktura Përgjegjëse | Hapat Proceduriale | Mënyra Veprimit | Afatet Kohore |
|--|--|---|---|---------------------------|
| Plani vjetor i financimit të OJF-ve të autorizuara nga Ministri i Drejtësisë | Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas 1. Drejtoria e Financave, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse; 2. Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore | Pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Duxhetin, hartohet plani vjetor i financimit të OjF-ve të autorizuara sipas përcaktimeve të pikës 4 të VKM nr. 110/2019, të ndryshuar. | Publikimi i planit vjetor të financimit në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas | Janar 2025 |
| Hapja e thirrjes së përgjithshme për financimin e OjF-ve të autorizuara | Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas 1. Drejtoria e Financave, Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetëse; 2. Drejtoria e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore | Pas publikimit të planit vjetor të financimit hapet thirrja për financimin e OJF-ve të autorizuara sipas kriterëve të përcaktuara në pikën 5 të VKM nr. 110/2019, të ndryshuar. | Publikimi i thirrjes në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas dhe pranë Buletinit të Njoftimeve Zyrtare | Janar 2025 |
| Ngritja e Komisionit Vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financimin e OJF-ve; Komisioni i ankimimit për shqyrtimin e ankesave për shkelje të qëllimshme të | Ministria e Drejtësisë; Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas | Përcjellja e shkrësive dërguar MD për caktimin e 2 anëtarëve në KVO dhe 2 anëtarëve në KA sipas VKM-së nr.110/2019, të ndryshuar. | Institucional, shkrësor. | Janar 2025 –Shkurt |

| | | | | |
|---|---|--|--|---|
| <p>procedurës së shqyrtimit si dhe sekretariatit teknik mbështetës.</p> | | <p>Ngritja e KVO dhe KA me urdhër të Ministrit të Drejtësisë</p> | <p>Komisioni vlerësues dhe komisioni i ankimit ngrihen me urdhër të ministrit të Drejtësisë jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e njoftimit të thirrjes sipas pikës 5, VKM-së nr.110/2019, të ndryshuar.</p> | |
| <p>Analizimi i dokumentacionit Teknik/Administrativ të Organizatave Jofitimprurëse të autorizuar</p> | <p>Komisioni Vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financimin e OJF-ve</p> | <p>Komisioni vlerësues, brenda 7 (shtatë) ditëve nga administrimi i kërkesës për përfitimin e financimit, kryen veprimet e mëposhtme: a) Kur kërkesa përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të këtij vendimi, njofton organizatën jofitimprurëse mbi vazhdimin e procedurës së verifikimit të kriterëve; b) Kur kërkesa nuk përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të këtij vendimi, njofton organizatën jofitimprurëse për plotësimin e të metave brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit. Mosplotësimi i të metave brenda afatit përben shkak për mospranimin e kërkesës."</p> | <p>KVO shqyrton aplikimet për përmbushjen e kriteve të përgjithshme dhe të veçanta</p> | <p>Komisioni vlerësues shqyrton aplikimet dhe vlerëson përmbushjen e kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, si dhe cakton masën financiare përfituese sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 60 ditë nga dita e mbylljes së thirrjes publike.</p> |

| | | | | |
|--|--|---|---|---|
| <p>Ndjekja e procedurës së ankimit</p> | <p>Komisioni i ankimit për shqyrtimin e ankesave për shkelje të qëllimshme të procedurës së shqyrtimit</p> | <p>Vlerësimi i ankimit nëse ka shkaqe ligjore dhe është paraqitur brenda afateve</p> | <p>Nxjerrja e vendimit të arsyetuar për pranimin ose mospranimin e ankimit.</p> | <p>15 ditë nga data e paraqitjes së ankimit.</p> <p>Njoftimi i arsyetuar i vendimit dhe publikimi në faqen zyrtare të DNJF, brenda 2 ditëve nga marrja e vendimit.</p> |
| <p>Shpallja e fitueseve</p> | <p>Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas</p> | <p>Lidhja e kontratës I vjeçare të financimit sipas përcaktimeve të pikës 20 të VKM nr. 110/2019 të ndryshuar dhe shtojcës të Urdhrit nr. 226, datë 25.03.2019, të Ministrit të Drejtësisë, “<i>Për miratimin e kontratave të ndihmës juridike të garantuar nga shteti</i>”</p> | <p>Kontratë individuale për çdo OJF të shpallur fituese pas plotësimit të kriterëve</p> | <p>Mars 2025</p> |

- ❖ Hapja e thirrjes së përgjithshme për financimin e organizatave jofitimprurëse të autorizuara
- ❖ **Aneks 1: Lista e dokumentave të nevojshëm për aplikim (origjinale ose të njehsuara me origjinalin)**

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim duhet të përcillet pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas në rrugë postare, sipas legjislacionit në fuqi.

Përbën shkak automatik skualifikimi, mungesa e dokumentacionit sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta, *përveç dokumentacionit që përbën avantazh (cituat).*

Përbën shkak automatik skualifikimi, përcjellja e dokumentacionit në format jo origjinal ose të panjehsuar me origjinalin.

| Kritere të përgjithshme mbi organizimin dhe funksionimin e OJF-ve të autorizuara Të përditësuara=Të 3 (tre) muajve të fundit |
|--|
| 1. Deklaratë e përfaqësuesit ligjor të organizatës jofitimprurëse të autorizuar që nuk përfiton burime të ngjashme/njëjta financimi për ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore. <i>(Deklarata TIP sipas thirrjes).</i> |
| Kritere të veçanta- Kapacitetet e burimeve njerëzore/personelit Të përditësuara=Të 3 (tre) muajve të fundit |
| <ol style="list-style-type: none"> 1. ID e anëtarëve të organeve vendimmarrëse dhe përfaqësuesit ligjor të organizatës; 2. CV e përfaqësuesit ligjor të organizatës; 3. Përshkrimet e punës dhe kontratat e punës të punonjësve të organizatës <i>(avokatë; jurist¹; financier dhe çdo punonjës tjetër që ka rol në plotësimin e objektivave të projektit) Të gjitha kontratat në vijimësi që punonjësi ka lidhur me organizatën që nga momenti i rekrutimit në organizatë;</i> 4. Certifikatat e trajnimeve të punonjësve të lartpërmendur në fushën e ndihmës juridike <i>(nëse ka përbën avantazh në procesin e pikëzimit²);</i> 5. Vërtetim nga prokuroria dhe gjykata se anëtarët e organeve vendimmarrëse dhe përfaqësuesit ligjor të organizatës nuk janë në proces hetimi apo gjykimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike <i>(i përditësuar³);</i> 6. Vërtetim nga prokuroria dhe gjykata për punonjësit e organizatës që nuk janë në proces hetimi apo gjykimi për çështje që cenojnë besimin e publikut dhe ofrimin e përshtatshëm të ndihmës juridike <i>(i përditësuar);</i> |

¹ Të evidentohet përvoja si jurist/financier në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike që nga momenti i angazhimit pranë organizatës.

² Nuk përbëjnë shkak për skualifikim por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mos përcjellja e dokumentacionit që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.

³ Me dokument të përditësuar nënkuptojmë të gjithë dokumentat e gjeneruar brenda 3 (tre) muajve të fundit nga data e shpalljes së thirrjes në QBZ.

| Kritere të veçanta- Aktivitet afatgjata të organizatës |
|--|
| <ol style="list-style-type: none"> 1. Certifikatë pronësie e ambientit ku ushtrohet aktiviteti ose kontratë qiraje; 2. Kopje të inventareve fizikë të pajisjeve (<i>kompjuter; printera; tavolina; karrike etj.</i>) që disponon organizata në funksion të ushtrimit të aktivitetit të punonjësve ose çdo dokument tjetër që vërteton gjendjen e aseteve në funksion të veprimtarisë së OJF-së (<i>Për vitin 2024</i>) (<i>Përbën avantazh</i>)⁴; 3. Dokument (foto) që vërteton faktin se vendodhja e organizatës është lehtësisht e aksesueshme nga qytetarët (<i>e pajisur me rampë ose ashensor</i>) dhe mjediset ku do të ofrohet shërbimi të ofrojnë mundësinë e aksesimit nga personat me aftësi të kufizuar (<i>Përbën avantazh</i>) 4. Dokument (foto) që vërteton faktin se organizata mundëson një ambient të veçuar për trajtimin e rasteve të shërbimit të ndihmës juridike parësore me një karakter sensitive (<i>dhunë në familje, të mitur në konflikt me ligjin, etj.</i>) (<i>Përbën avantazh</i>) |
| Kritere të veçanta- Kapaciteti financiar i Organizatës Të përditësuar=Të 3 (tre) muajve të fundit |
| <ol style="list-style-type: none"> 1. Kopje të kontratave të grantit të lidhura me partnerë në kuadër të zbatimit të projekteve të ngjashme, të lidhura pas procedurës së autorizimit (pas Tetorit 2024)⁵; 2. Deklaratë ku të specifikohet vlera totale e fondit për secilin projekt të njëjtë/të ngjashëm të përcjellë nga organizata në kuadër të procedurës së autorizimit për vitin 2024, si dhe projektet e lidhura pas procedurës së autorizimit (<i>pas Tetorit 2024</i>); 3. Letër reference nga partnerët për realizimin e suksesshëm të kontratave të grantit (<i>përbën avantazh</i>)⁶; 4. Vërtetim nga organet tatimore që organizata nuk ka detyrime tatimore të papaguara (<i>i përditësuar</i>); 5. Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për deklarimin e pagesave të kontributeve për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat për të gjithë punonjësit (<i>i përditësuar</i>) për të cilët janë përcjellë përshkrimet e punës; 6. Listëpagesa e punonjësve sipas legjislacionit në fuqi (<i>borderoja e pagave e 3 (tre) muajve të fundit</i>) shoqëruar me dokumentin që vërteton pagesën ku të evidentohen punonjësit e organizatës (<i>avokatë; jurist; financier dhe çdo punonjës tjetër që ka rol në plotësimin e objektivave të projektit</i>) për të cilët janë përcjellë përshkrimet e punës; 7. Vërtetim i llogarisë bankare të organizatës; 8. Vërtetim që organizata nuk është në proces falimentimi (<i>i përditësuar</i>); 9. Raport Vlerësues Përfundimtar i kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare të OJF-së |

⁴ Nuk përbëjnë shkak për skualifikim por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mos përcjellja e dokumentacionit që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.

⁵ Në rast se nuk janë lidhur kontrata granti pas muajit Tetor 2024, muaj i cili korrespondon me urdhrin e autorizimit nga Ministri i Drejtësisë, do të merren për bazë projektet e përcjellja në thirrjen për autorizim, të cilat do të vihen në dispozicion nga Sekretariati Teknik i ngritur pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

⁶ Nuk përbëjnë shkak për skualifikim por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mos përcjellja e dokumentacionit që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.

| |
|--|
| i ushtruar nga shoqëri të licencuara auditimi (<i>përbën avantazh</i> ⁷); 10. Oferta financiare e projektit sipas thirrjes. |
| Kritere të veçanta- Performanca e Organizatës që nga momenti i autorizimit për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga Ministri i Drejtësisë |
| <ol style="list-style-type: none"> 1. Deklaratë mbi numrin total të rasteve të ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, të raportuara pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas që nga momenti i autorizimit nga Ministri i Drejtësisë për periudhën 2024-2026 (<i>Tetor 2024-Dhjetor 2024</i>)⁸; 2. Letra vlerësimi nga të paktën 2 (dy) subjekte përfituese nga shërbimet e ndihmës juridike parësore shoqëruar me kopje të ID dhe numër kontakti të qytetarëve përfitues. (<i>Përbën avantazh</i>)⁹. |

❖ **Aneks 2: Formular TIP i Aplikimit:**

PJESA I: INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

| | |
|---|--|
| Titulli i projektit | |
| Emri i Organizatës Jofitimprurëse | |
| Statusi ligjor (<i>së bashku me ndryshimet që kanë pësuar aktet themelore të organizatës, duke bashkëngjitur vendimet përkatëse të gjykatës, Nr.</i>) | <i>Numri i Vendimit dhe Data e regjistrimit në Gjykatë;</i> <i>NIPT-i</i> |
| | <i>Emri i Bankës Numri IBAN Nr. i Llogarisë Bankare (në lekë)</i> |
| Autorizim i Ministrit të Drejtësisë | <i>Nr. dhe data e autorizimit nga Ministri i Drejtësisë.</i> |
| Adresa: | |
| E-mail: | |
| Ëbbsite: | |
| Vendi/-et ku zbatohet projekti | |
| Personi i kontaktit | |

⁷ Nuk përbëjnë shkak për skualifikim por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mos përcjellja e dokumentacionit që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.

⁸ Në rast se numri i rasteve të përcaktuara në deklaratë nuk korrespondon me numrin e rasteve të raportuara pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në baza mujore, do të merret në konsideratë në procesin e pikëzimit, numri i rasteve të raportuara në DNJF.

⁹ Nuk përbëjnë shkak për skualifikim por ndikojnë në procesin e vlerësimit të projekteve. Mos përcjellja e dokumentacionit që përbën avantazh, vlerësohet me 0 pikë në tabelën e vlerësimit.

| | |
|---|--|
| Pozita në organizatë | |
| Fondet e Kërkuara nga DNJF: | |
| Përshkrim i projekteve të ngjashme/ të njëta në rend zbritës. | |
| Nënshkrimi i drejtuesit/përfaqësuesit të Organizatës. | |

PJESA II - PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Qëllimi i projektit: Përshkruani shkurtimisht projektin, problematikën që ai adreson, si dhe argumentimin se si projekti u përgjigjet objektivit të përcaktuar në thirrje. *(maksimumi 10 rreshta)*.
[Shpjegoni...]

Aktivitetet kryesore realizimin e objektivit *(maksimumi 5 rreshta përshkrim për secilin aktivitet)*

1. **Rekrutimi i 1 (një)** juristi për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti nga ana e organizatës;
2. Lidhja e kontratës së punës me organizatën jofitimprurëse të autorizuar që përfiton financim dhe **kryerja e pagesave mujore për pagat/sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (punëdhënës dhe punëmarrës)** për juristin që do të ofrojë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti;
3. **Ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore nga juristi i organizatës jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë.**
4.
5.
6.
7.

Shënim:

- 3 (tre) aktivitetet e para janë aktivitete të detyrueshme për t'u plotësuar në kuadër të përmbushjes së objektivit të përgjithshëm.
- Në projekt-propozim mund të shtohen aktivitete të tjera, të cilat nuk mund të përfshihen në tabelën financiare të projekt-propozimit.

A përmban projekti tregues objektivisht të verifikueshëm lidhur me rezultatet e aktiviteteve (Targeti)? *(Maksimumi 3 rreshta për secilin aktivitet):*

Aktiviteti 1:

Rezultatet e pritura dhe treguesit:

Aktiviteti 2:

Rezultatet e pritura dhe treguesit:

Aktiviteti 3:

Rezultatet e pritura dhe treguesit:

.....

- **Shënim Aktiviteti nr. 1: Juristi duhet të ketë minimalisht 1 (një) vit eksperiencë pune në profesion.**
- **Shënim Aktiviteti nr. 2: Paga për funksion nuk duhet të jetë më e madhe se kategoria IV-3 sipas Vendimit nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar.**

Shënim Aktiviteti nr. 3: minimalisht për 200 (dyqind) raste në vit, por jo më pak se 50 (pesëdhjetë) raste çdo 3 (tre) muaj, ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti për sa kohë ky i fundit është real dhe përmbushet nga ana e organizatës në procesin e monitorimit të kontratës së financimit. (Theksojmë se çelja e fondit sipas kontratës së financimit do të realizohet me fazë. Mos plotësimi i targetit sipas fazave, përbën shkak për mos kalimin e fondit të fazës pasardhëse).

PJESA III – KALENDARI I REALIZIMIT TË AKTIVITETEVE

| Muaji | Aktiviteti | Aktiviteti | Aktiviteti | Aktiviteti | Aktiviteti | Aktiviteti |
|---------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|
| Mars | | | | | | |
| Prill | | | | | | |
| Maj | | | | | | |
| Qershor | | | | | | |
| Korrik | | | | | | |
| Gusht | | | | | | |
| Shtator | | | | | | |
| Tetor | | | | | | |
| Nëntor | | | | | | |
| Dhjetor | | | | | | |
| Janar | | | | | | |
| Shkurt | | | | | | |

PJESA IV- PËRFITUESIT E DREJTËPËRDREJTË NGA PROJEKTI

NËNSHKRIMI

Datë _____

❖ Aneks 3: Plani i financiar i aktiviteteve dhe pagesave

Periudha: _____ deri në _____

| | | | | | |
|---|--|--|---|---|------------------------|
| <i>Objektivi i përgjithshëm</i> | Sigurimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore për kategoritë përfituese të ligjit nr. 111/2017, "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti" në mënyrë profesionale, cilësore, efiçente dhe efektive. | | | | |
| Aktiviteti nr. 1 | | | | | |
| Rekrutimi i 1 (një) juristi për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti nga ana e organizatës; | Procedura e rekrutimit ndiqet nga vetë organizata. (Nuk kostohet) | | | | |
| Aktiviteti nr. 2 | Numri i punonjësve të rekrutuar | Kategoria e pagës së punonjësit | Paga totale bruto e punonjësit në muaj | Paga totale bruto e punonjësit për 12 muaj | Sqarime/Shënime |
| Llogaritja dhe kryerja e pagesave të pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për juristin që do të ofrojë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti: (këtu përfshihet paga bruto së bashku me sigurimet që paguhen nga punëdhënësi në masën 16.7%) | XX | XX | XX | XX | |
| Total | | | | | |

Shembull referues (Paga):

| nr. | Emër Mbiemër | Emërtesa sipas strukturës së miratuar | Kategori /klasa | Paga e grupit | Paga për funksion | Shtesa page për vjetërsi në punë | | | Paga mujore neto |
|-----|--------------|---------------------------------------|-----------------|---------------|-------------------|----------------------------------|---|---------------------|------------------|
| | | | | | | Vite | % | Shtesa për vjetërsi | |
| | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | |
|---|------------|------------|------|------------------------------|--------|---|-----|-----|--------|
| 1 | Punonjes x | Specialist | IV-3 | 14.000 12.000 10.000 | 70.000 | 1 | 0.6 | 420 | 67.890 |
| 2 | Punonjes y | Specialist | IV-4 | 14.000/ 12.000/ 10.000 | 60.000 | 1 | 0.6 | 360 | 60.265 |

*Shënim: Tabela e mësipërme është tabelë referuese për kategoritë e pagave. Paga neto e punonjësit mund të ndryshojë nga vitet e vjetërsisë në punë që mund të ketë punonjësi. Paga totale që përfshin pagën neto, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të punëdhënësit dhe të punëmarrësit llogariten nga organizata jofitimprurëse aplikuese.

Baza ligjore referuese për llogaritjen e pagave dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore dhe tatimin mbi të ardhurat:

- VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar;
- **Paga për funksion nuk duhet të jetë më e madhe se kategoria IV-3** sipas Vendimit nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar Paga grupit 14.000 lekë i referohet grupit të diplomës Master i Shkencave; 12.000 lekë i referohet Masterit Profesional dhe paga e grupit 10.000 lekë i referohet diplomës Bachelor sipas legjislacionit për arsimin e lartë dhe lidhjes nr.2 të Vendimit 325 datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve....”
- Juristi i rekrutuar duhet të ketë minimalisht 1 (një) vit eksperiencë pune në profesion.

❖ Aneks 4: Formati raportit të realizimit të projektit sipas fazave (pas lidhjes së kontratës)

| Objektivat | Targeti sipas projekt propozimit | Realizimi i targetit për x mujorin e parë | Sasia e pagesës së autorizuara sipas fazave (Faza e parë, dytë, tretë) | Realizimi aktual i projektit | Balanca | Shënime: (Dokumenta të dorëzuara) |
|------------------|----------------------------------|---|--|------------------------------|-----------------|-----------------------------------|
| | | | B | D | E= (B-D) | |
| Aktiviteti nr. 1 | | | | | | |
| Aktiviteti nr.2 | | | | | | |

Shënim: Në rast se vlera e ofertuar nuk arrin dot të realizohet në masën 100% nga organizata fituese diferenca e fondeve evidentohet në raportin përfundimtar dhe kthehet në buxhetin e shtetit, në përfundim të kontratës.

❖ Ngritja e Komisionit të Vlerësimit dhe Komisionit të Ankimit

Mënyra e ngritjes, mbledhjes dhe funksionimit të Komisionit të Vlerësimit dhe Komisionit të Ankimit përcaktohet në mënyrë të detajuar në VKM nr. 110/2019, të ndryshuar si dhe në kreun 6 të Rregullores së Brendshme të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, miratuar me Urdhrin nr. 393 datë 23.11.2020, të Ministrit të Drejtësisë.

❖ Ngritja e Sekretariatit Teknik

Në mbështetje të nenit 15 të ligjit Nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga Shteti”; Vendimit Nr.110, datë 6.3.2019 “Për përcaktimin e procedurave dhe të rregullave të përzgjedhjes së organizatave jofitimprurëse, të autorizuara për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit dhe mënyra e financimit të tyre”, të ndryshuar, Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas” miratuar me Urdhër nr. 393 datë 23.11.2020, të Ministrit të Drejtësisë, ngrihet Sekretariatit Teknik i cili mbështet veprimtarinë e Komisionit Vlerësues dhe Komisionit të Ankimit për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikimeve për financim të Organizatave Jofitimprurëse të Autorizuara, kryesisht përmes:

- Zbardhjes së vendimeve të marra në mbledhjen e Komisionit të Vlerësimit dhe Komisionit të Ankimit;
- Njoftimit të anëtarëve të Komisioneve përkatëse për pjesëmarrjen në mbledhje;
- Mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve;
- Kryerjes së njoftimeve përkatëse për organizatat jofitimprurëse të autorizuara, pjesëmarrëse në proces.
- Vendosjes në dispozicion të Komisionit të Vlerësimit dhe Komisionit të Ankimit të dokumentacionit që është administruar gjatë procesit të autorizimit Tetor 2024, kryesisht si më poshtë vijon:
 1. Kopje të kontratave të grantit të lidhura me partnerë në kuadër të zbatimit të projekteve të përcjella gjatë procedurës së autorizimit nga Ministri i Drejtësisë për vitin 2024, si dhe deklaratat ku përcaktohet fondi për secilin projekt si dhe burimi i financimit;
 2. Statuti i Organizatës Jofitimprurëse të Autorizuar ku objekti i veprimtarisë së organizatës të jetë dhe ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike;
 3. Akti i themelimit të Organizatës Jofitimprurëse të Autorizuar;
 4. Vërtetimi gjyqësor nga Zyra e Regjistrimit të OJF-ve ku të evidentohen përfaqësuesit e organeve vendimmarrëse dhe përfaqësuesi ligjor i organizatës jofitimprurëse (*Drejtori Ekzekutiv*);
 5. Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (*NIPT*);
 6. Akti i autorizimit nga Ministri i Drejtësisë për ofrimin e ndihmës juridike parësore të garantuar nga shteti marrë në vitin 2024.
 7. Pasqyrat financiare të vitit të fundit të nënshkruara nga hartuesi i pasqyrave financiare dhe të nënshkruara nga drejtuesi i Organizatës, të konfirmuara nga Drejtoria e Përgjithshme e

Tatimeve;

- Vendosjen në dispozicion të rasteve përcjella në baza mujore nga Organizatat Jofitimprurëse të Autorizuara nga Ministri i Drejtësisë në ofrimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore, tek punonjësi i autorizuar për plotësimin, përditësimin dhe dërgimin për publikim të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese.

Sekretariati Teknik të ketë në përbërjen e tij 3 (tre) persona.

❖ Deklarata e paanshmërisë dhe konfidencialitetit

Të gjithë anëtarët e Komisionit të vlerësimit, Komisionit të Ankimit dhe anëtarët e Sekretariatit Teknik duhet të nënshkruajnë një **deklaratë me shkrim të paanshmërisë dhe konfidencialitetit**. (sipas aneksit 5) Ky akt i detyron të ruajnë konfidencialitet të plotë të informacionit që përmbajnë projekt-propozimet, si dhe paanshmëri në procesin e vlerësimit të projektit. Nënshkrimi i deklaratës garanton integritetin e të gjithë informacionit brenda procesit të vlerësimit deri sa rezultatet të botohen dhe të vihen në dispozicion të publikut të gjerë. Kjo mbron interesin e aplikantëve si dhe të gjithë pjesëtarëve të tjerë në këtë proces.

Aneks 5

FORMULAR I DEKLARATËS SË PAANËSISË, KONFIDENCIALITETIT DHE SHMANGIES SË KONFLIKTIT TË INTERESIT

Unë, _____ i nënshkruar si më poshtë, vërtetoj se unë si anëtar i Komisionit Vlerësues/Komisionit të Ankimit/Sekretariatit Teknik _____ të ngritur me Urdhrin nr. _____, datë _____ do të veproj konform legjislacionit në fuqi, në mirëbesim, në mënyrë të paanshme dhe në përputhje me parimin e shmangies së konfliktit të interesave dhe, prandaj, deklaroj se unë:

1. Do të mbaj në mënyrë konfidenciale të gjitha informacionet që i posedoj;
2. Do të veproj vetëm në bazë të rregullave profesionale dhe objektive në përputhje me legjislacionin në fuqi;
3. Do të veproj në mënyrë plotësisht të pavarur, të paanshme dhe të barabartë për të gjitha propozim-projektet në procesin e përzgjedhjes, pa ndonjë ndikim të jashtëm;

Në rast të paraqitjes së rrethanave që dëmtojnë ose mund të dëmtojnë objektivitetin dhe paanshmërinë time ose rrezikojnë parimin e shmangies së konfliktit të interesave, unë personalisht do të paraqes kërkesë për përjashtimin tim, dhe do të kërkoj nxjerrjen e vendimit nga organi kompetent për të më përjashtuar nga anëtarësia dhe nga procedura.

Aneks 6

DEKLARATË MBI FINANCIMIN E DYFISHTË

Aplikuesi: (Emri i OJF-së) _____ me
përfaqësues ligjor _____ identifikuar me ID _____

Deklaroj se _____ përfitoj burime të tjera financimi për të njëjtin aktivitet të ofrimit të ndihmës juridike parësore me përgjegjësi se të gjitha informacionet e përfshira në këtë deklaratë janë të vërteta, të sakta dhe të plota.

Vendi dhe data:

Emri i plotë dhe nënshkrimi i përfaqësuesit ligjor të OJF-së

Shënim. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas legjislacionit në fuqi.

❖ Vlerësimi paraprak i projekt-propozimeve

Hapi i parë në procesin e vlerësimit, përpara se të bëhet shqyrtimi i hollësishëm i projekt-propozimeve të dorëzuara, është verifikimi nëse të gjithë aplikantët i kanë plotësuar kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura në thirrje. Komisioni kontrollon nëse në aplikim është përfshirë dokumentacioni i detyrueshëm. Komisioni vlerësues, brenda 7 (shtatë) ditëve nga administrimi i kërkesës për përfitimin e financimit, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) Kur kërkesa përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të këtij vendimi, njofton organizatin jofitimprurëse mbi vazhdimin e procedurës së verifikimit të kritereve;
- b) Kur kërkesa nuk përmban të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, sipas parashikimeve të këtij vendimi, njofton organizatën jofitimprurëse për plotësimin e të metave brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit. Mosplotësimi i të metave brenda afatit përben shkak për mospranimin e kërkesës."

Të gjitha projekt- propozimet regjistrohen më vete dhe mbahet një proces-verbal. Çdo proces-verbal nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

❖ Renditja dhe përzgjedhja e projekt-propozimeve

Anëtarëve të komisionit iu jepet tabela e vlerësimit që përbëhet nga kriteret dhe nën-kriteret të paraqitura në formën e një tabele. Pas kësaj duhet të fillojë procesi i shqyrtimit/leximit të projekt-propozimeve.

Pikët maksimale për vlerësimin përfundimtar të OJF-ve janë 50 pikë; Në aktin përfundimtar të vlerësimit do të renditen OJF-të me pikët më të larta në rend zbritës i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit.

❖ Tabelë vlerësimi përmblledhëse e Projekt-Propozimit

| | Pikët maksimale | Pikët maksimale | Pikët maksimale | Pikëzimi mesatar |
|---|--------------------|--------------------|--------------------|---------------------|
| | Anëtari 1 | Anëtari 2 | Anëtari 3 | |
| 1. Kapaciteti i Organizatës Jofitimprurëse për projekte të ngjashme | 10 | | | |
| 1.1 A ka organizata eksperiencë të mjaftueshme në menaxhimin e projekteve të ngjashme? | | | | |
| 1.2 A disponon organizata vërtetime nga partnerët për realizimin e suksesshëm të kontratave të grantit apo raporte vlerësuese pozitive të kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare të OJF-së, të ushtruara nga shoqëri të licencuara auditimi? | | | | |
| 2. Kapaciteti profesional i burimeve njerëzore të organizatës | 12 | | | |
| 2.1 A kanë punonjësit e organizatës (avokatë/jurist) përvojë në fushën e ndihmës juridike sipas kontratave të lidhura ndër vite me organizatën? | | | | |
| 2.2 A kanë punonjësit e organizatës përvojë në fushën e financës sipas kontratave të lidhura ndër vite me organizatën? | | | | |
| 2.3 A disponojnë punonjësit e organizatës (avokatë/jurist) certifikata trajnimi në fushën e ndihmës juridike? | | | | |
| 2.4 A disponon organizata letra vlerësimi nga të paktën 2 (dy) subjekte përfituese nga shërbimet e ndihmës juridike parësore? | | | | |
| 3. Ambiente të përshtatshme, të aksesueshme nga qytetarët | 8 | | | |
| 3.1 A disponon organizata një vendodhje lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët? A ofrojnë mjediset ku do të ofrohet shërbimi mundësinë e aksesimit nga personat me aftësi të kufizuara? | | | | |
| 3.2 A disponon organizata pajisje të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit të punonjësve? (Lista e inventarëve që OJF administron) | | | | |
| 3.3 A mundëson organizata një ambient të veçuar për trajtimin e rasteve të shërbimit të ndihmës juridike parësore me një karakter sensitiv? | | | | |
| 4. Performanca e Organizatës që nga momenti i autorizimit për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga Ministri i Drejtësisë | 10 | | | |
| 4.1 Numri i rasteve të raportuara në baza mujore | | | | |
| 5. Buxheti dhe efikasiteti i kostos së projekt-propozimit | 10 | | | |

| | | | | |
|---|--|--|--|--|
| 5.1 Sa është kostoja e zbatimit të projektit kundrejt targetit të parashikuar në projekt-propozim nga Organizata Jofitimprurëse (numri i rasteve të shërbimit të ndihmës juridike)? | | | | |
|---|--|--|--|--|

❖ Informacion sqarues mbi tabelën e vlerësimit:

Kapaciteti i Organizatës Jofitimprurëse për projekte të ngjashme (10 pikë)

Pyetja 1.1: (Maksimumi i vlerësimit 5 pikë)

Në rast se vlera mesatare nga të gjitha projektet e përcjella nga organizata¹⁰ është me e madhe ose e barabartë me dy-fishin e shumës maksimale të financimit referuar thirrjes së DNJF, kjo pyetje vlerësohet me **5 pikë**¹¹;

Në rast se vlera mesatare nga të gjitha projektet e përcjella nga organizata¹² është sa vlera e shumës maksimale të financimit referuar thirrjes së DNJF, deri në dy-fishin e shumës maksimale të financimit, kjo pyetje vlerësohet me **3 pikë**;

Në rast se vlera mesatare nga të gjitha projektet e përcjella nga organizata¹³ është më e vogël se shumata maksimale e financimit referuar thirrjes së DNJF kjo pyetje vlerësohet me **1 pikë**;

| Vlera mesatare nga projektet e ngjashme të tre viteve të fundit | Pikët e vlerësimit |
|---|--------------------|
| >ose = 3 200 001 lekë | 5 pikë |
| 1 600 001 lekë - 3 200 000 lekë | 3 pikë |
| < ose = 1 600 000 lekë | 1 pikë |

Pyetja 1.2: (Maksimumi i vlerësimit 5 pikë)

Nëse organizata disponon vërtetim nga partnerët për realizimin e suksesshëm të kontratave të grantit si dhe raport vlerësues pozitiv të kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare të ushtruara nga shoqëri të licencuara auditimi, kjo pyetje vlerësohet me **5 pikë**.

Në rast se organizata disponon të paktën të paktën 1 raport vlerësues pozitiv të kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare të OJF-së, të ushtruara nga shoqëri të licencuara auditimi por jo vërtetim nga partnerët për realizimin e suksesshëm të kontratave të grantit kjo pyetje vlerësohet me **3 pikë**.

¹⁰ Vlera totale e fondit për secilin projekt të njëjtë/të ngjashëm të përcjellë nga organizata në kuadër të procedurës së autorizimit për vitin 2024, si dhe projektet e lidhura pas procedurës së autorizimit (pas Tetorit 2024);

¹¹ Në përlllogaritje merret për bazë vlera totale e projektit të deklaruar nga OJF-ja dhe jo vlera e lidhur vetëm me aktivitetin “*ofrimi i ndihmës juridike falas*”

¹² Vlera totale e fondit për secilin projekt të njëjtë/të ngjashëm të përcjellë nga organizata në kuadër të procedurës së autorizimit për vitin 2024, si dhe projektet e lidhura pas procedurës së autorizimit (pas Tetorit 2024);

¹³ Vlera totale e fondit për secilin projekt të njëjtë/të ngjashëm të përcjellë nga organizata në kuadër të procedurës së autorizimit për vitin 2024, si dhe projektet e lidhura pas procedurës së autorizimit (pas Tetorit 2024);

Në rast se organizata disponon të paktën 1 vërtetim nga partnerët për realizimin e suksesshëm të kontratave të grantit por jo raport vlerësues pozitiv të kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe financiare të ushtruara nga shoqëri të licencuara auditimi, kjo pyetje vlerësohet me **2 pikë**.

Kapaciteti profesional i burimeve njerëzore të organizatës (12 pikë)

Pyetja 2.1 (Maksimumi i vlerësimit 4 pikë)

Në rast se përvoja e mesatare e të gjithë punonjësve të organizatës (*avokatë; jurist*) për të cilët janë përcjellë përshkrimet e punës është me shumë se 2 vite përvojë në fushën e ndihmës juridike pranë organizatës aplikuese, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **4 pikë**.

Në rast se se përvoja e mesatare e të gjithë punonjësve të organizatës (*avokatë; jurist*) për të cilët janë përcjellë përshkrimet e punës është 1 deri në 2 vite përvojë në fushën e ndihmës juridike pranë organizatës aplikuese, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **2 pikë**.

Në rast se se përvoja e mesatare e të gjithë punonjësve të organizatës (*avokatë; jurist*) për të cilët janë përcjellë përshkrimet e punës është deri në 1 vit përvojë në fushën e ndihmës juridike pranë organizatës aplikuese, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **1 pikë**.

Pyetja 2.2 (Maksimumi i vlerësimit 4 pikë)

Në rast se përvoja e mesatare e të gjithë punonjësve të organizatës (*financier*) është më shumë se 2 vite përvojë në fushën e financës pranë organizatës aplikuese, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **4 pikë**.

Në rast se përvoja e mesatare e të gjithë punonjësve të organizatës (*financier*) është 1 deri në 2 vite përvojë në fushën e financeë pranë organizatës aplikuese, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **2 pikë**.

Në rast se përvoja e mesatare e të gjithë punonjësve të organizatës (*financier*) është deri në 1 vit përvojë në fushën e financës pranë organizatës aplikuese, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **1 pikë**.

Në rast se organizata nuk ka të punësuar një financier, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **0 pikë**¹⁴.

Pyetja 2.3 (Maksimumi i vlerësimit 2 pikë)

Në rast se të gjithë punonjësit e organizatës (*avokatë; jurist;*) për të cilët janë përcjellë përshkrimet e punës disponojnë certifikata trajnimi në fushën e ndihmës juridike atëherë kjo pyetje vlerësohet me **2 pikë**.

Në rast se disa prej punonjësve të organizatës (*avokatë; jurist;*) për të cilët janë përcjellë përshkrimet e punës disponojnë certifikata trajnimi në fushën e ndihmës juridike, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **1 pikë**.

Në rast se asnjë prej punonjësve të organizatës (*avokatë; jurist;*) për të cilët janë përcjellë përshkrimet e punës nuk disponon certifikata trajnimi në fushën e ndihmës juridike, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **0 pikë**.

¹⁴ Ndryshe nga punësimi i një avokati dhe/ose juristi, pozicion pune i cili është i domosdoshëm në momentin që organizata jofitimprurëse aplikuese është një organizatë e autorizuar për të ofruar shërbimin e ndihmës juridike parësore.

Pyetja 2.4 (Maksimumi i vlerësimit 2 pikë)

Në rast se organizata disponon letra vlerësimi nga 2 (dy) ose më shumë subjekte përfituese nga shërbimet e ndihmës juridike parësore, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **2 pikë**.

Në rast se organizata disponon letra vlerësimi nga 1 (një) subjekt përfitues nga shërbimet e ndihmës juridike parësore, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **1 pikë**.

Në rast se organizata nuk disponon letra vlerësimi nga subjektet përfituese nga shërbimet e ndihmës juridike parësore, atëherë kjo pyetje vlerësohet me **0 pikë**.

Ambiente të përshtatshme, të aksesueshme nga qytetarët (8 pikë)**Pyetja 3.1 (Maksimumi i vlerësimit 3 pikë)**

Në rast se organizata është e vendosur në një vendndodhje lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët (*pranë institucioneve publike si gjykatat, bashkitë, apo institucione të tjera publike*), si dhe ofron lehtësirat për aksesimin nga personat me aftësi të kufizuar (rampë/ashensor etj.) kjo pyetje vlerësohet me **3 pikë**.

Në rast se organizata nuk është e vendosur në një vendndodhje lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët (*pranë institucioneve publike si gjykatat, bashkitë, apo institucione të tjera publike*), por ofron lehtësirat për aksesimin nga personat me aftësi të kufizuar (rampë/ashensor etj.) kjo pyetje vlerësohet me **2 pikë**.

Në rast se organizata është e vendosur në një vendndodhje lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët (*pranë institucioneve publike si gjykatat, bashkitë, apo institucione të tjera publike*), por nuk ofron lehtësirat për aksesimin nga personat me aftësi të kufizuar (rampë/ashensor etj.) kjo pyetje vlerësohet me **2 pikë**.

Në rast se organizata nuk është e vendosur në një vendndodhje lehtësisht të aksesueshme nga qytetarët si dhe nuk ofron lehtësirat për aksesimin nga personat me aftësi të kufizuar kjo pyetje vlerësohet me **0 pikë**.

Pyetja 3.2 (Maksimumi i vlerësimit 3 pikë)

Në rast se organizata, referuar listës së inventarëve disponon mjete elektronike dhe pajisje zyresh në proporcion me numrin e punonjësve të deklaruar në listëpagesë kjo pyetje vlerësohet me **3 pikë**.

Në rast se jo/ose në rast se ky dokumentacion nuk është përcjellë, kjo pyetje vlerësohet me **0 pikë**.

Pyetja nr. 3.3 (Maksimumi i vlerësimit 2 pikë)

Në rast se organizata mundëson një ambient të veçuar për trajtimin e rasteve të shërbimit të ndihmës juridike parësore me një karakter sensitiv kjo pyetje vlerësohet me **2 pikë**.

Në rast se jo, kjo pyetje vlerësohet me **0 pikë**.

Performanca e Organizatës që nga momenti i autorizimit për ofrimin e ndihmës juridike parësore nga Ministri i Drejtësisë për vitin 2024-2026 (10 pikë)**Pyetja nr. 4.1 (Maksimumi i vlerësimit 10 pikë) (minimalisht 50 raste për 3 muaj, Tetor 2024-Dhjetor 2024)**

| Numri i rasteve të ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike parësore | Pikët e vlerësimit |
|--|--------------------|
| Mbi 60 raste | 10 pikë |
| 50-59 raste | 7 pikë |
| 40-49 raste | 5 pikë |
| 30-39 raste | 2 pikë |
| 20-29 raste | 1 pikë |
| Nën 20 raste | 0 pikë |

Pyetja nr. 5.1 (Maksimumi i vlerësimit 10 pikë)

| Kosto për njësi (<i>Buxheti total në projekt porpozim në raport me numrin e rasteve të përcaktuara në target nga ana e organizatës lidhur me aktivitetin: "4. Ofrimi i shërbimeve të ndihmës juridike parësore nga juristi i rekrutuar"</i>) | Pikët e vlerësimit |
|--|--------------------|
| Deri në 3,300 | 10 pikë |
| 3,301 – 3,800 | 8 pikë |
| 3,801 – 4,300 | 6 pikë |
| 4,301 – 4,800 | 4 pikë |
| 4,801 – 5,300 | 2 pikë |